

VENDIM
Nr. 614, datë 30.7.2026

**PËR MBYLLJEN E NDËRMARRJES SHTETËRORE “KANTIERI I NDËRTIMIT
DHE RIPARIMIT TË ANIJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar; të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike”; të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve” (KNRA), me seli në Pashaliman, Vlorë.

2. Pasuritë me nr. 150/22, nr. 150/23, nr. 150/24, nr. 150/25 dhe nr. 150/26, në zonën kadastrale 1569, me vendndodhje në Pashaliman, Orikum, Vlorë, kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për Komandën e Forcës Detare.

3. Punonjësit dhe asetet e ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”, pas mbylljes, transferohen në strukturën e Komandës së Forcës Detare.

4. Dorëzimi i inventarit të kësaj ndërmarrjeje bëhet nga një komision, me përfaqësues të Komandës së Forcës Detare dhe me përfaqësues të ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”.

5. Detyrimet e ndërmarrjes shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve”, të krijuara deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, llogariten në vlerën totale prej 69 640 394 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e dyzet mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) lekësh, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Efektet financiare, sipas pikës 5, të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, në programin buxhetor “Forcat e luftimit”.

7. Vendimi nr. 397, datë 11.5.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore ‘Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve’”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Komanda e Forcës Detare dhe ndërmarrja shtetërore “Kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Aneks nr. 1

**TABELA E DETYRIMEVE FINANCIARE TË NDËRMARRJES SHTETËRORE
“KANTIERI I NDËRTIMIT DHE RIPARIMIT TË ANIJEVE”, TË CILAT
TRANSFEROHEN PRANË KOMANDËS SË FORCËS DETARE:**

Në lekë

Nr.	Zëri i detyrimit	Përshkrim	Shuma (ALL)
1.	Shpenzime postare	Detyrim i papaguar	16 430
2.	Shpenzime internet	Detyrim i papaguar	155 560
3.	Shpenzime energjie elektrike	Detyrim kryesor	22 681 173,53
4.	Kamatëvonesa energjie elektrike	Penalitete	7 669 217,41

5.	Shpenzime karburanti	Detyrim i papaguar	932 100
6.	Shpenzime ekspert kontabël	Detyrim i papaguar	1 020 000
7.	Detyrime tatimore	Total detyrim tatimor	12 697 296
8.	Detyrime ndaj ish-punonjësve (BRUTO)	Detyrime financiare	20 858 948
9.	Paga e muajit qershor 2026 (BRUTO)	Detyrim pagash	2 900 000
10.	Taksa e bashkisë	Detyrim vendor	102 000
11.	Shpërblime dhe leje për ish-punonjës (BRUTO)	Detyrim vendor	607 669
12.	TOTALI I DETYRIMEVE FINANCIARE		69 640 394